

**VENDIMI I KUVENDIT TE AKSIONARËVE TE SHOQËRISË
JOOS & KRASNIQI – BAZE SHPK**

Sot më 12.08.2024, u mbajt takimi i shoqërise **JOOS KRASNIQI – BAZE SHPK** një shoqëri me përgjesi të kufizuar, me seli të vendosur në Junik, Decan, Kosove, e regjistruar në Regjistrin e shoqërive në Kosove, me numer unik identifikues 810962309, (Ketu e me poshte referuar si "Shoqëria") janë të pranishëm në takim antëtarët e kuvendit të aksionarëve të shoqërise

- **Z. Agron Krasniqi**, shtetas kosovar, lindur më 25.12.1979, në Gjakove, Kosove, me banim në Gjakove-Kosove, mbajtës i kartes se identitetit me Nr. Personal 1009378436;
- **Z. Zenun Krasniqi**, shtetas kosovar, lindur më 28.02.1972, në Gjakove, Kosove, me banim në Gjermani, në adresën: Zünfatstrasse 4, Marlen, Kehl 77694, mbajtës i kartes se identitetit me nr. Personal 1030754014 i përfaqësuar me autorizimin e përgjithshme me LRP nr. 11908/2018, date 29.11.2018, nga Z. Agron Krasniqi, , atesia Musa, i datelindjes 25.12.1979, lindur Gjakove, Kosove, shtetas Kosovar, mbajtës i kartes se identitetit kosovare me Nr. Personal 1009378436;
- **Z. Fatmir Krasniqi**, shtetas kosovar, lindur më 18.01.1976, në Gjakove, Kosove, me banim në Gjermani, në adresën: Zünfatstrasse 4, Marlen, Kehl 77694, mbajtës i dokumentit pasaport Gjermane me nr. C96JGC2KR, i përfaqësuar me autorizimin e përgjithshme me LRP nr. 11908/2018, date 29.11.2018,, nga Z. Agron Krasniqi, , atesia Musa, i datelindjes 25.12.1979, lindur Gjakove, Kosove, shtetas Kosovar, mbajtës i kartes se identitetit kosovare me Nr. Personal 1009378436.

Kjo mbledhje do diskutojë dhe vendosë për sa vijon:

RENDI I DITËS:

1. Themelimi i një degë në Shqipëri.

Shoqëria synon të krijojë një degë në Shqipëri me emrin **JOOS KRASNIQI – BAZE Degë e shoqërise se huaj** me seli ligjore në e Rruga "Abdyl Frashëri", Godina Vesa Center, Kati 3, Tirane, Shqipëri.

Të gjithë të pranishmit deklarojnë se janë të informuar për pikat e rendit të ditës dhe konfirmojnë këtë mbledhje si të thirrur të rregullt dhe të aftë për të vendosur mbi rendin e ditës të propozuar.

Pas një diskutimi të gjerë dhe të plotë të pikave të rendit të ditës dhe në përputhje me kompetencat e dhëna nga Statuti i Shoqërisë, neni nr 4.3 në menyre unanime është

VENDOSUR:

1. Krijimi i një degë në Shqipëri.

Të krijohet dhe regjistrohet një degë në Shqipëri e quajtur **JOOS KRASNIQI – BAZE Degë e shoqërisë së huaj**.

2. Objekti i veprimtarisë:

Fusha e veprimtarisë së degës do të jetë: Kryerjen e aktivitetit në ndërtimet civile, industriale, infrastrukture, ushtarake etj., si për llogari të vet ashtu dhe për të tretet, ku përfshihen ndërtime pallatesh banimi, godina social-kulturore, komplekse industriale, ndërtimet rrugore, hekurudha, porte, aeroporte, ura dhe vepra arti, centrale elektrike, linja të tensionit të lartë dhe të mesëm, ujësjellësa, kanalizime, impiante të pastrimit, sinjalistike rrugore, punime topo-gjeodezike etj; Shfrytëzim karrierash lumore dhe malore, prodhim inertesh, llaçi, betoni, parafabrikatesh, materialesh asfaltike, materialesh të tjera të nevojshme në përgjithësi dhe për tregtimin e tyre për kryerjen e punimeve të ndërtimit në përgjithësi si dhe tregtimin e tyre; Punime inxhinierike projektimi, duke përfshirë por pa u kufizuar në vepra urbane, arkitekture, punime ndërtimi, instalimi, pune hidraulike, punime rrugore dhe hekurudhore, ura dhe vepra 2 arti, inxhinieri topografike dhe hidrologjike, inxhinieri, studime gjeologjike, pune inxhinierike të impianteve të prodhimit dhe transemitimit të energjisë etj. Pjesëmarrje në tendera të të gjitha llojeve si dhe marrja përsiper e projekteve të ndërtimit vetëm ose në bashkëpunim me çdo person fizik ose juridik nëpërmjet komisionit direkt për shtetin, organizatat publike ose private, dhe çdo organizatë tjetër të sektorit publik duke përfshirë dhe organet e qeverisjes vendore; Kryerjen e të gjitha veprimeve tregtare, industriale dhe financiare mbi pasuri të luajteshme dhe të paluajteshme, të quajtura nga



administratoret te nevojshme per ushtrimin e aktivitetit te shoqerise, etj. Punime civile per rikualifikim urban, Transport te mallrave brenda vendit me mjete jashte norme per llogari te vete. Grumbullim, transportim i mbetjeve nga llumrat, pastrimi i gropave septike.

3. Zyra e regjistruar e Degës

Zyra e regjistruar (selia) e Degës do të jetë në: Rruga "Abdyl Frashëri", Godina Vesa Center, Kati 3, Tirane, Shqipëri.

4. Kohëzgjatja

Dega do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohore të pacaktuar.

5. Qeverisja e Degës

Të caktojë Përfaqësues Ligjor të Degës në Shqipëri **Z. Agron Krasniqi**, shtetas kosovar, lindur më 25.12.1979, në Gjakove, Kosove, me banim në Gjakove-Kosove, mbajtës i kartes se identitetit kosovare me nr. Personal 1009378436, madhor me zotësi të plotë për të vepruar. Përfaqësuesi Ligjor do të ketë të drejtë të përfaqësojë Degën e Shoqërisë në Shqipëri para të tretëve, institucioneve ose entiteteve publike ose private; të lidhë kontrata për dhe në emër të degës me çdo palë të tretë; të punësojë dhe të shkarkojë punonjës ose staf tjetër sipas nevojës për drejtimin e biznesit në Shqipëri; të përfaqësojë degën në Shqipëri përpara çdo banke të nivelit të dytë dhe të kryejë çdo transaksion financiar në llogarinë e degës, të kryejë çdo veprim ose biznes ose aktivitet tjetër që konsiderohet i nevojshëm për veprimtarinë e degës në Shqipëri; të ndryshojë selinë dhe/ose të hapë zyra/seli dytësore në Shqipëri, të punësojë dhe të shkarkojë punonjës ose staf tjetër sipas nevojës për drejtimin e biznesit në Shqipëri; t'i japë çdo përfaqësuesi sipas zgjedhjes së tij delegim të caktuar të kompetencave ose kompetenca të përgjithshme që konsiderohen të nevojshëm, brenda kufijve të kompetencave që ai i ka me ligj dhe nga ky Vendim.

6. Përfaqësim Ligjor për krijimin e Degës

Të caktojë **Z. Oltjan Hoxholli**, mbajtës i Kartës ID me nr. Personal I10929118F dhe/ose **Znj. Katerina Kacani**, mbajtëse e Kartës ID me nr. Personal J76109090B dhe/ose **Znj. Fjolida Bodurri**, mbajtëse e Kartës ID me nr. Personal J66009026T dhe/ose **Znj. Tea Thomaj**, mbajtëse e kartës ID me nr. Personal J76230017R dhe/ose **Znj. Ervana Cullhaj**, mbajtëse e Kartës së ID me nr Personal. J65119034P, dhe/ose **Znj. Albana Fona** mbajtëse e Kartës së Identitetit me Nr. Personal J15521073G dhe/ose **Z. Bledar Rakipaj**, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. Personal J10430068C bashkarisht dhe/ose veçmas, të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme në lidhje me të gjitha procedurat e nevojshme për ngritjen e Degës në Shqipëri, duke përfshirë por pa u kufizuar në përgatitjen, rishikimin, ndryshimin, nënshkrimin dhe depozitimin e dokumenteve përkatëse pranë Autoriteteve Shqiptare (duke përfshirë veçanërisht Qendrën Kombëtare Shqiptare të Regjistrimit, Autoritetet Tatimore, Zyrën e Punës, Zyrën e Sigurimeve Shoqërore, Bashkinë e Tiranës apo gjetkë, dhe çdo autoritet tjetër publik që mundet. të kërkohet nga legjislacioni shqiptar).

Pas kësaj, duke qenë se askush nuk e kërkon fjalën dhe nuk ka asgjë tjetër për t'u diskutuar, mbledhja mbyllet. Nga veprimet e kryera dhe të njohura me këtë procesverbal që, i hartuar në vend, lexohet, vërtetohet dhe nënshkruhet.

**KUVENDI I AKSIONARËVE TE SHOQËRISE
JOOS & KRASNIQI – BAZE SHPK**

